

## Aneks I

1. Lejet për zhvillim apo ndërtim për objektet që shtrihen në një rreze brenda 5 (pesë) kilometra nga pika e referimit të aeroportit, merren pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim "KKTU"), sipas parashikimeve në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar.
  
2. Lejet për zhvillim apo ndërtim për objektet që shtrihen në rrezen përtej 5 (pesë) kilometra deri në 15 (pesëmbëdhjetë) kilometra nga pika e referimit të aeroportit, merren pranë autoritetit vendor përgjegjës për zhvillimin e territorit, sipas parashikimeve në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar, me kushtin e marrjes së aktit të konformitetit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit si sekretariat teknik i KKTU-së lidhur me projektin e propozuar dhe mendimit të Autoritetit të Aviacionit Civil. Çdo leje e miratuar nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, në kushtet e mungesës, apo dhënies së një përgjigje negative mbi aktin e konformitetit nga Sekretariati teknik i KKTU-së apo mendimit të Autoritetit të Aviacionit Civil, do të konsiderohet e pavlefshme.